

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Perfaqesues/e i/eAksionerit _____)


Ju njoftojmë se ditën e Marte datë 16 Maj 2017, ora 10:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore të "Banka Credins" sh.a për vitin 2016 sipas IFRS.
2. Propozim për miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore të "Banka Credins" sh.a për vitin 2016 sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë
3. Propozim për miratimin e Rezultatit Financiar të "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës së Shqipërisë sh.a për vitin 2016.
4. Propozim për riemërimin e z. Maltin Korkuti, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Banka Credins sh.a
5. Propozim për miratimin e ekspertës kontabël të autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit të fitimit të pasqyrendare të vitit 2016.
6. Propozim për miratimin e ekspertit kontabel të autorizuar të Banka Credins sh.a për vitin ushtrimor në vazhdim.
7. Propozim për riemërimin e dy anëtarëve të Komitetit të Kontrollit të Banka Credins sh.a, Znj. Eva Pango dhe Z. Elton Toro për një periudhë katër vjecare.
8. Propozim për dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive date 17.05.2017 me rend dite si më poshtë:
 - 1) Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, Pasqyrave Financiare të audituara të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Pasqyrave Financiare të audituara të Fondit të Pensionit "Sicred Pensions", si dhe Pasqyrave Financiare të audituara të Fondit të Investimit "Credins Premium", për vitin e mbyllur deri më 31 Dhjetor 2016;
 - 2) Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të Shoqërisë Administruese "Credins Invest" sh.a., për vitin e mbyllur deri më 31 Dhjetor 2016;
 - 3) Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
9. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet perkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane me 25.04.2017

